

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja: Fillim Skoro, kryetar, Have Haliti dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesionale, Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.Q. nga Gjilani, për shkak të veprës penale, posedimi, i pa paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe përgjigjen ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. R.S., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.66/2017 të datës 12.06.2017, në seancën e kolegjit me datën 8.08.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

1.Me aprovimin e ankesës se Prokurorisë Themelore- DKR në Gjilan, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore DKR në Gjilan, PKR.nr.66/2017 i datës 12.06.2017, përkitazi me vendimit mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit A.Q., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, posedimi i pa paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, i cili dënim me kërkesën e të akuzuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtë qind) €, e merr si të vërtetuar, por shqipton edhe dënim me gjobë në shumë prej 100(njëqind) euro, pra gjithsejtë i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 700 €, të cilën gjobë duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se aktgjyqimit, nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, të njëjtit gjoba i zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro, i llogaritet një ditë burgim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore DKR në Gjilan, me aktgjykimin PKR.nr.66/2017 të datës 12.06.2017, të akuzuarin A.Q., e ka shpallur fajtor për veprën penale, posedimi, i pa paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, për të cilën vepër penale e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditë, i cili dënim me kërkesën e të akuzuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtë qind) €.Të akuzuarit i është shqiptuar dënimi

plotësues, i është konfiskuar substanca narkotike të llojit kanabis (marihuanë) në peshë të përgjithshme prej 15.3 gram, si dhe substanca narkotike e llojit heroin me peshë prej 06 gr. Të akuzuarin e ka obliguar t'i paguajë shpenzimet e procedurë penale sipas llogarisë së gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit i janë kthyer të hollat e sekuestruara në shumë prej 350 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore në Gjiilan, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, të akuzuarit t'i shqiptojë dënim me burgim dhe me gjobë më të lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. R.S., ka bërë përgjigje në ankesën e prokurorisë, ka propozuar që Gjykata e Apelit të refuzoj si të pa bazuar ankesën e prokurorisë, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta vërtetoi.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.321/2017, të datës 12.07.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjiilan, të aprovohet, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë, , ndërsa përgjigje në ankesën e prokurorisë të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK, ka mbajtur seancën e kolegjit, por nuk i ka ftuar palët në procedurë, sepse të akuzuarit nuk i është shqiptuar dënim me burgim.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, të Prokurorisë Themelore në Gjiilan, përgjigje në ankesën e prokurorisë të mbrojtësit të akuzuarit, pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa Prokurorisë Themelore-DKR në Gjiilan është e bazuar.

Gjykata e Apelit, duke pasur parasysh se aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, por e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, por aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoi vetëm sa i përketë vendimit mbi dënimin.

Prokuroria në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, mirëpo sa i përket vendimit mbi dënimin, konsideron se dënimi i shqiptuar nuk është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, duke pasur parasysh se veprat e tilla janë në rritje dhe kryesisht viktimat janë të rinjtë dhe me

një dënim të tillë nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, ka propozuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim më i lartë dhe dënim me gjobë.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit të akuzuarit, ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese, se i akuzuari ka pranuar fajësinë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, pendimin për veprën e kryer penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra tjera penale, kurse si rrethana rënduese e ka marrë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale.

Kjo gjykatë gjenë se, gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh, sjelljen e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, se më parë nuk ishte i dënuar, ka shpreh pendim të thellë për vepër e kryer penale, ka premtuar se në të ardhmen nuk ka përsërit vepër tjetër penale, duke i pasur parasysh të gjitha këto rrethana lehtësuese i ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit dhe i ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë me ligj. Prokuroria në ankesë propozon që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me gjobë dhe burgim më i lartë, kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e prokurorisë në ankesë janë të bazuara se për këtë vepër penale është paraparë dënimi komulativ me gjobë dhe burgim, kurse gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar vetëm dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditë, i cili dënim me kërkesën e të akuzuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtë qind) €, pa e cekur fare edhe dënimin me gjobë, që është paraparë sipas nenit 275 par. 1 të KPRK-së, andaj duke i vlerësuar pretendimet ankimore të Prokuroris Themelore në Gjilan. Gjykata e Apelit ndryshoi aktgjykimin e ankimuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale për të cilat është shpallur fajtor i akuzuari, si dhe shkalla e përgjegjësisë penale të akuzuarit, e me bindje se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 401 të KPPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.332/2017 me 8.08.2017

Procesmbajtësja,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetari i kolegjit,

Bujar Balaj

1.Have Haliti,_____

Fillim Skoro

2.Abdullah Ahmeti,_____

